

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gruaja që akuzoi Jay-Z për sulm seksual tërheq akuzat? “Nuk e kam takuar kurrë” Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/gruaja-qe-akuzoi-jay-z-per-sulm-seksual-terheq-akuzat-nuk-e-kam-takuar-kurre/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 13:09:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 13:07:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6752b0490976bf2249691fb03bab7b830636d35f20f52e665ebc01603f79cc1a
TEKSTI	907e6ba4df74c459e1123988059a9719866da1499d21ef4df63239b745e0eeaa
PAMJA	2195aba783a12c1cb90642bc9b7c8dfbb4ccf622c467606c27b18a2f0e1e65a4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a14bbd5de364482b586402a829f3d314985ffcc826d7f0b8835a6af0c6c0cdcd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7a6930be9f3749f4980fd84dca137394dacb19a29045da8941f5e341c088ecc2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a14bbd5de364482b586402a829f3d314985ffcc826d7f0b8835a6af0c6c0cdcd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Gruaja që akuzoi Jay-Z për sulm seksual tërheq akuzat? “Nuk e kam takuar kurrë”



Redaksia K

26 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Gruaja që në vitin 2024 akuzoi **Jay-Z** për përdhunim ka tërhequr zyrtarisht pretendimet e saj, duke deklaruar në një dokument të dorëzuar në gjykatë se reperi nuk e ka sulmuar kurrë dhe se ajo nuk e ka takuar apo folur me të.

Në një deklaratë prej 12 faqesh, gruaja, e identifikuar si “Jane Doe”, shkroi se nuk kishte asnjë të vërtetë në akuzat që kishte bërë ndaj Shawn Carter, emri i vërtetë i **Jay-Z**.



Shawn ‘Jay-Z’ Carter nuk më ka përdhunuar kurrë. Nuk e kam takuar apo folur kurrë me zotin Carter. Zoti Carter nuk ka kryer asnjë veprim të papërshtatshëm ndaj meje

-thuhet në deklaratën e saj.

Ajo shtoi se pretendimet e mëparshme ishin të pavërteta dhe pranoi se akuzat i kishin shkaktuar reperit "dhimbje, vuajtje dhe dëme që nuk mund të zhbëhen plotësisht". Gruaja deklaroi gjithashtu se nuk ishte paguar për deklaratën e re.

Gruaja kishte ngritur një padi civile në vitin 2024, duke pretenduar se ishte vetëm 13 vjeçe kur ishte sulmuar seksualisht pas një feste të organizuar pas ceremonisë së MTV Video Music Awards në vitin 2000.

Në padinë e saj ajo kishte akuzuar Jay-Z dhe Sean "Diddy" Combs për sulm seksual, ndërsa pretendonte se një tjetër person i famshëm kishte qenë i pranishëm.

Jay-Z i kishte mohuar kategorikisht akuzat që në fillim. Çështja kundër tij u tërhoq nga gruaja në vitin 2025, ndërsa reperi më pas ngriti një padi kundër saj dhe ekipit ligjor që e kishte përfaqësuar, duke pretenduar se akuzat kishin qenë të rreme.

Në deklaratën e re, gruaja shpjegon se në vitin 2024 kishte parë një reklamë në Facebook që kërkonte persona me pretendime për abuzim seksual ndaj Sean Combs.

Sipas saj, reklama i riktheu kujtime për një sulm seksual që ajo besonte se kishte përjetuar në moshën 13-vjeçare. Pas kontaktit me ekipin ligjor, ajo dha versionin e saj të ngjarjeve dhe padia u përgatit.

Megjithatë, në fillim të vitit 2025 ajo thotë se nisi të dyshonte për saktësinë e kujtimeve të saj dhe madje nëse kishte qenë ndonjëherë në një festë me persona të famshëm.

Akuzat i bëri i ri James Blair Newman. Në deklaratën e kësaj shtetëse të thotë se ka qenë

Avokati i saj, James Brian Newman Jr., ka deklaruar se kështu vazhdon të atë se ka qenë viktimë e një sulmi seksual, por se ishte "tërësisht e gabuar" në identifikimin e Jay-Z si personin përgjegjës.

Pas deklaratës së re, avokatët e Jay-Z kanë hequr gruan nga procesi gjyqësor që reperi kishte ngritur ndaj saj. Megjithatë, çështja e tij ligjore kundër avokatit Tony Buzbee dhe firmës së tij vazhdon.

Buzbee, i cili kishte përfaqësuar gruan në padinë fillestare, ka kundërshtuar disa nga pretendimet e reja dhe ka deklaruar se versioni i saj aktual për ngjarjet është informacion i ri për të.

Deklarata e fundit nuk përcakton vetvetiu se çfarë dinin avokatët për saktësinë e pretendimeve në momentin kur çështja u ngrit. Kjo mbetet një nga çështjet kryesore në padinë që Jay-Z po ndjek kundër ekipit ligjor.

Ndërkohë, tërheqja e akuzave shënon një kthesë të rëndësishme në një prej çështjeve ligjore që kanë përfshirë reperin gjatë viteve të fundit.

LAJME TË NGJASHME



Përplasje e re për Diddy-n? Avokatët kërkojnë të largohen nga çështja?

3.5 MIN



Jay-Z i këndon Beyoncé-s në ditëlindjen e saj në koncert?

1.5 MIN



Kthesë e re për P Diddy-n, shtyhet sërish data e lirimit nga burgu?

1 MIN



Rita Ora rikthehet te skandali i "Becky with the good hair"? "Do të doja shumë të..."

2.5 MIN



Tërmeti la pas qindra të vdekur, Beyoncé dhuron 1 milion dollarë për viktimat!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Punë e paqëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi zbulon lidhjen me plakjen e trurit!



Gjiganti italian i modës Gucci nxjerr në treg atlete "Made in China"!



Cindy Crawford përjetoi vite të vështira për djalin e saj?



Madonna tërheq vëmendjen me fotografi provokuese, pozon me reçipeta transparente?



"The Real Housewives" përballet me kritika? A është jeta e Wayne dhe Coleen Rooney vërtet kaq autentike?






"Send Nudes"? Sydney Sweeney shfaqet provokuese në një tjetër fushatë?



A kaloni shumë kohë ulur? Ja çfarë mund të ndodhë nëse ecni çdo gjysmë ore!



A ju ndodh të shihni të njëjtën ëndërr vazhdimisht? Çfarë mund të fshihet pas saj?



Tanimë gjërat kanë ndryshuar/Shenjat e zodiakut që më në fund po fillojnë një kapitull të ri të jetës së tyre!



Nations League, sonte SHQIPERI vs. BJELLORUSI/Ekskluzivisht në DigitAlb!

EDITORI SUGJERON



Sa kalori digjen gjatë vërtetë seksit?!



"Zemra ndalet për gjysmë ore..." / Prof. Dr. Altin Veshti zbulon çfarë ndodh gjatë operacionit: Pacientët kanë frikë!



Melatonina apo L-Theanine?! Ja cili suplement mund të ndihmojë më shumë me gjumin...



Të njëjtat vargje të përsëriten gjithë ditën? Ja pse një këngë mund të të "ngecë" në kokë...



Një ilaç i ri për kancerin e pankreasit mund t'u japë pacientëve më shumë kohë!




"Një politikan, vajza e Alfred Cakos dhe..." / Bledi Mane zbulon banorët e këtij sezoni të BBV?



A vazhdon të jetë i virgjër? At Nikolla Xhufka tregon si vepron kur përballet me tundimet seksuale: Edhe tani me vajza të bukura...



"Me bezdis përndjekja..." / Ina Aderi: Më kanë ngacmuar personazhe, do dashurohem larg kamerave...



Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb!



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktoni Marketing Frekuencat Aksesueshmëria

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav](#) widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.